



Institucioni i Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës
Institucija Ombudsmana Republike Kosovo
Ombudsperson Institution of Republic of Kosovo



Për: Z. Albin Kurti, Kryeministër
Z. Besnik Bislimi, Zëvendës Kryeministër
Z. Hekuran Murati, Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve

Datë: 9 Gusht 2022
Prishtinë

Lënda: Qëndrim i përbashkët për Projektligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe Projektligjin për Financat e Pushtetit Lokal

I nderuar Kryeministër,
I nderuar Zëvendës Kryeministër,
I nderuar Ministër,

Në emër të organizatave dhe institucioneve nënshkruese të kësaj letre zyrtare, shprehim konsideratën tonë më të lartë për gatishmërinë tuaj për të adresuar të drejtat e fëmijëve edhe përmes hartimit dhe ndryshimit të legjislacionit përkatës në Kosovë.

Sipas Planit Legjislativ të Qeverisë, Projektligji për Financat e Pushtetit Lokal dhe Projektligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare parashikohen të miratohen në shtator dhe nëntor të vitit 2022.

Projektligji për Shërbime Sociale dhe Familjare tashmë është finalizuar dhe e ka kaluar fazën e konsultimeve publike. Ky është Ligj bazik që ofron mbështetje për fëmijët dhe familjet në nevojë për mbrojtje sociale. Është shumë e rëndësishme që Projektligji të procedohet dhe miratohet gjatë muajit nëntor të vitit 2022, ashtu siç parashihet me agjendën legjislative qeveritare.


Miratimi dhe zbatimi përkatës i këtij Ligji do të përmirësojë jetën e fëmijëve dhe familjeve në nevojë për mbrojtje sociale. Konkretisht, zbatimi efektiv i këtij Ligji pritet të ketë ndikim në jetën e mbi 30,000 mijë qytetarëve, përfshirë fëmijët pa kujdes prindëror, viktimat e dhunës në familje, trafikimit dhe shfrytëzimit, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët e përfshirë në punë të rënda, fëmijët viktimat të abuzimit me substanca narkotike, etj.

Ndërsa Projektligji për Financat e Pushtetit Lokal, i cili sipas agjendës legjislative qeveritare parashihet të miratohet në shtator të vitit 2022, për herë të parë parashihet krijimin e një Granti Specifik për Shërbime Sociale, i cili do të sigurojë një minimum të financimit për shërbimet sociale. Aktualisht nuk ka një mekanizëm të qëndrueshëm për financimin e shërbimeve sociale dhe familjare, si pasojë ofruesit e shërbimeve sociale janë në rrezik të vazhdueshëm të mbylljes së shërbimeve.


Mbyllja e shërbimeve sociale, qoftë edhe përkohësisht, do të lërë shumë fëmijë të cenueshëm pa shërbimet e domosdoshme dhe do të mbyllë derën për shumë raste të reja të fëmijëve që mund të kenë nevojë për mbrojtje sociale, duke cenuar kështu të drejtën themelore të fëmijës për mbrojtje.

Duke patur parasysh zvarritjen e procesit të miratimit të këtyre projektligjeve për disa vite si dhe nevojat e qytetarëve për shërbime shtesë pas situatës së rënduar nga pandemia Covid-19, konsiderojmë se Qeveria duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që miratimi i këtyre projektligjeve të bëhet brenda afateve të përcaktuara me agjendën legjislative.

Organizatat dhe institucionet nënshkruese:




Naim Qelaj, Avokat i Popullit



Donjetë Kelmendi, Drejtor Ekzekutiv

Koalicioni i OJQ – ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë - KOMF i cili përfaqëson 34 organizata si më poshtë:

ASTRA, Aksioni për Nëna dhe Fëmijë, Autizmi, Balkan Sunflowers Kosova, CHILDPROOF – CIPOF, Down Syndrome Kosova, Education Comes First, HANDIKOS, Handikos Ferizaj, Handikos Gjakova, Iniciativa 6, Qendra MVPT, NOPM, Nevo Koncepti, Organizata Rinore – AKTI, OPFAKKOS, OFAP, Programi për të Drejtat Civile, PL4Y International, POLIS, Qendra për Arsim në Kosovë, Qendra PEMA, Qendra për studime të avancuara – FIT, QKRMT, “SOS Kopshti”, Qendra “Labyrinth”, PEN, Save the Children, SOS Fshatrat e Fëmijëve, Shpresa Shtëpi për Fëmijët Kosovë, PRAK Kosova, Terre des hommes, The Ideas Partnership, VoRAE.



Blërim Shabani, Kryetar – Lidhja e Qendrave për Punë Sociale